| | |
|---|---|
| **Republika e Kosovës**<br>**Republika Kosova**<br>**Republic of Kosovo** | KAÇANIKU<br>**Komuna e Kaçanikut**<br>**Opština Kacanik**<br>**Municipal Kacanik** |

**04Nr.610/01-26511/20**
**Kaçanik: 30.10.2020**

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 30 Tetor 2020,pos tjerash u ;

**INFORMUA**

1. Me Aktivitetin e zhvilluar të DAK -Për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020, në bazë të dhënave të prezantuara në Informatën për përfundimin e vitit shkollor 2019/2020,e hartuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.

2. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese, është materiali më tekstin e mëtejmë: "Informatë për përfundimin e Vitit Shkollor 2019/2020 ", e përmbledhur në gjithsej : 19 faqe / Lënda: 04 Nr.610/01-26511/20.

3. Më këtë Shkresë njoftohet: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit,
Kemajl Mërseli

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

**Drejtoria e Arsimit dhe Kultures**
**04.Nr.** 610/01-26511/20

# I N F O R M A T Ë

**Për përfundimin e Vitit Shkollor 2019/2020**

**Kaçanik, Tetor 2020**

## Përmbajtja:


1. Hyrje
2. Qëllimi
3. Objektivat
4. Nivelet e arsimit – Edukimi dhe arsimi parafillor dhe fillor (0 dhe 1)
   - 4.1. Rrjeti shkollor
   - 4.2. Nxënësit e nivelit 0 dhe 1 (Parafillor dhe Fillor) dhe suksesi
5. Nxënësit e nivelit 2 (VI – IX) dhe suksesi
6. Numri i nxënësve dhe suksesi në arsimin fillor dhe mesëm të ulët (I – V dhe VI -IX)
7. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve
8. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (AML)
   - 8.1. Numri i nxënësve dhe suksesi në fund të vitit shkollor
   - 8.2. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve
9. Provimi i Maturës


**Shkurtesat:**

- DAK - Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
- MASH - Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- PF - Parafillor ose niveli 0
- AF - Arsimi Fillor ose niveli 1 (klasa I-V)
- AMU - Arsimi i Mesëm i Ulët ose niveli 2 (klasa VI-IX)
- AML - Arsimi i Mesëm i Lartë ose niveli 3 (klasa X-XII)
- IKShPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
- KShM - Këshilli Shtetëror i Maturës

## 1. Hyrje

Informata për vitin shkollor 2019–2020 përmban punët dhe aktivitetet njëvjeçare të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës dhe ka për qëllim të njoftoj institucionet komunale dhe publikun e gjërë mbi gjendjen e përgjithshme në fushën e arsimit në Komunën e Kaçanikut dhe trendet zhvillimore përgjatë vitit shkollor 2019/2020.

Viti shkollor 2019-20 përfundoi në rrethana të jashtëzakonshme si pasojë e pandemisë COVID 19 në përputhje me kushtet e krijuara dhe duke i respektuar në tërësi udhëzimet dhe vendimet e MASH e IKShPK për fillimin e mësimit në kushte pandemie.
Në përputhje me ligjet në fuqi dhe vendimet e ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës për organizimin e mësimit në kushtet e pandemisë COVID – 19, MASH (më herët MASHT), në bashkëpunim me DKA-të, ka ndërmarrë dhe ka koordinuar masat dhe aktivitetet për organizimin dhe mbarëvajtjen e mësimit në distancë në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë.

Më 11 mars, Qeveria e Kosovës pati vendosur që në përputhje me vendimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë të shpall gjendje pandemie në nivel global në lidhje me koronavirusin (COVID 19) duke ndërmarrë disa masa parandaluese, përfshirë edhe mbylljen e shkollave që nga 12 marsi, fillimisht për periudhën deri më 27 mars 2020.

Më 30 mars 2020, pati filluar mësimi në distancë për klasat 6 -9, ndërkaq që nga 23 marsi, mësimin e filluan klasat 1 – 5. Me iniciativë të drejtorisë së SHMP "Feriz Guri edhe në këtë institucion pati filluar mësimi në distancë më 23 mars përmes platformës elektronike Google Classroom, ndërsa në Gjimnazin "Skënderbeu", mësimi filloi më 30 mars, po ashtu përmes platformës Google Classroom. Mësimi në distancë është realizuar nëpërmjet transmetimit të mësimeve të regjistruara në televizionin publik (RTK) dhe përmes kanalit të MASHTI në YouTube (e-mësimi), si dhe përmes mësimit virtual të organizuar nga mësimdhënësit me ndihmën e aplikacioneve si: Zoom, Google Classroom, Hangouts Meet, G-mail, Hotmail, Instagram, Viber dhe facebook.

Ndërkohë, ka filluar edukimi edhe për grup moshat 0-6 duke vepruar sipas Vendimit të datës 14.04.2020 për zbatimin e edukimit në distancë për fëmijëri të hershme për moshën 0-6 vjeçare në Republikën e Kosovës.

Në mbarëvajtjen sa më me sukses të mësimit në distancë dhe koordinimit të punëve e aktiviteteve të DAK-së me drejtorët e institucioneve arsimore e rrjedhimisht edhe me mësimdhënës e nxënës kanë shërbyer Udhëzimet e MASH për DKA-të, Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë, Udhëzime për formimin e raportimit përmbledhës për realizimin e orëve/aktiviteteve mësimore gjatë mësimit në distancë, Informata, udhëzime dhe rregulla për kandidatët (maturantët), për Provimin e Maturës, Njoftimi për hapjen e kopshteve dhe çerdheve e dokumenteve tjera të cilat kanë qenë në zbatim. Po ashtu, drejtorët e të gjitha niveleve kanë vazhduar të ushtrojnë kompetencat e veta duke përfshirë edhe monitorimin e mësimit në distancë, ndërsa kanë vazhduar edhe komunikimin në distancë me mësimdhënësit, prindërit, nxënëst e DAK-në. Ndërkaq, drejtorët kanë vazhduar të përpilojnë Raporte javore të cilat i kanë përcjell në DAK duke e prezantuar punën javore të shkollave. Vlenë të theksohet edhe bashkëpunimi dhe angazhimi në masë të konsiderueshme i mësimdhënësve dhe prindërve, sikurse edhe i nxënësve të cilët gjatë kësaj periudhe kanë qenë mjaft aktiv. Natyrisht, gjatë kësaj periudhe janë shfaqur edhe probleme e vështirësi të ndryshme si mungesa e pajisjeve teknologjike, mos angazhimi i duhur i disa mësimdhënësve e prindërve, mungesa e shkathtësive të disa mësimdhënësve, kryesisht mësimdhënes të moshuar të cilët nuk njohin në masë të mirë përdorimin e pajisjeve teknologjike etj.

Gjatë kësaj periudhe të pandemisë COVID-19 është bërë përpjekje për mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së fëmijëve/nxënësve pasi, përveç tjerash pandemia ka sjell frikë, ankth e pasiguri te të gjithë fëmijët, ndërkaq që mësimdhënësit janë munduar të inkurajojnë fëmijët që të shmangin efektet negative psikologjike që ka mund të shkaktojë pandemia tek ata.

Masat dhe rregullat e zbatuara gjatë kësaj periudhe kanë ndikuar në mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve dhe është krijuar mundësia që çdo fëmije/nxënësi të shpalosë vlerat individuale, të ndjehet i pranuar, i vlerësuar dhe të përftojë maksimalisht nga procesi edukativo arsimor.

Në përmbyllje të vitit shkollor 2019 – 2020 është bërë edhe vlerësimi i nxënësve. Vlerësimin në distance është normuar me vendimin Nr. 25/01B, të datës 24.04.2020 për Procedurat e realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimit në distancë, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë, si dhe është mbështetur me udhëzime të ofruara në Udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë në kushtet e pandemisë COVID-19.

Sipas Vendimit nota përfundimtare në në fund të vitit shkollor 2019 – 2020, nuk duhet të jetë më e ulët se ajo e datës 11 mars, kur është ndërprerë mësimi i rregullt në shkollë për shkak të rrethanave të krijuara nga Pandemia COVID-19, ndërkaq janë marr parasysh edhe progresi i nxënësit dhe dëshmitë e mbledhura në ditarin personal të vlerësimit, para dhe gjatë mësimit në distancë.

Me gjithatë, edhe pse në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme është arritur të përmbyllet viti shkollor 2019- 2020 duke zbatuar mësimin online me qëllim të sigurimit të shërbimeve arsimore dhe realizimin e kurrikulës shtetrore të Kosovës në përputhje me kushtet e krijuara në rrethana të pandemisë COVID – 19.

Përmes këtij dokumenti, në formë tabelare janë prezantuar pasqyrat të cilat ofrojnë të dhëna për numrin e nxënësve sipas shkollave e sipas klasave, suksesin e arritur, numrin e orëve të humbura të nxënësve e mësimdhënësve, kualifikueshmërin e të dhëna tjera të përgjithshme.
Të dhënat e pasqyrura mundësojnë analizimin e gjendjes së përgjithshme në sistemin e arsimit publik që zhvillohet në Komunën e Kaçanikut, në përputhje me Ligjin Nr.03/L-068 për Arsimin në Komuna të Republikës së Kosovës, e që zhvillohet në katër nivele: në nivelin 0, 1, 2, dhe 3 ((Parafillor, Fillor, të Mesëm të Ulët dhe të Mesëm të Lartë).

Fillimit të vitit shkollor 2019/2020, sikurse edhe viteve të mëhershme, i kanë paraprirë aktivitetet përgatitore si përgatitja teknike e objekteve shkollore, furnizimi i shkollave me materiale pedagogjike, furnizimin e nxënësve me tekste shkollore, regjistrimin e nxënësve në klasat e para dhe klasë të dhjeta e kompletimin e kuadrit mësimor.

Fillimit të vitit shkollor 2019 – 2020 i ka paraprirë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve parafillor e atyre në klasat e para. Bazuar në raportet e 12 shkollave fillore amë, këtë vit shkollor janë regjistruar gjithsej 472 fëmijë parafillor prej tyre 449 në Shkollat fillore e të mesme të ulëta të shpërndarë në 25 paralele e 40 grupe e 23 fëmijë të tjerë të sistemuar në QEAP "Agimi", ndërkaq janë regjistruar gjithsej 481 fatos në gjithsej 27 klasa të para. Po ashtu, është bërë edhe planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat e X-ta, në 2 shkollat e mesme: në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka". Në Gjimnazin "Skënderbeu" janë regjistruar 223 nxënës, ndërsa ishin planifikuar të regjistrohen gjithsej 256 nxënës të ndarë në 2 drejtime me 8 paralele:

1. Shkenca Natyrore, 4 paralele
2. Shkenca Shoqërore-Gjuhësore, 4 paralele.

Ndërkaq, në SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" janë regjistruar gjithsej 164 nxënës në 10 paralele, ndërsa kanë qenë të planifikuar të regjistrohen gjithsej 344 nxënës të ndarë në 3 drejtimet:

1. Elektroteknikë me profilet: Teknik i Telekomunikacionit, Teknik i Informatikës dhe Instalues Elektrik me nga 1 paralele,
2. Ekonomi me profilet: Kontabilitet, Asistent i Marketingut dhe Tregti me shumicë dhe Pakicë me nga 1 paralele dhe

3. Makineri me profilet: Instalues i ngrohjes qendrore, Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, Automekanik dhe Operator prodhimi, po ashtu, me nga 1 paralele. Numri i vogël i nxënësve të regjistruar në klasat e dhjeta ka ndikuar që të mos themelohen 2 paralele të planifikuara: një në drejtimin ekonomik ( Shpedicion dhe Logjistikë) dhe paralelja Saldator e drejtimit Makineri.

## 2. Qëllimi

Që institucionet komunale dhe publiku të njoftohen mbi gjendjen e përgjithshme në sferën edukativo-arsimore në nivelet shkollore 0,1,2 dhe 3 (Parafillor, Arsimin Fillor, Arsimin e Mesëm të Ulët dhe Arsimin e Mesëm të Lartë) të komunës sonë për vitin shkollor 2019/2020.
DKA, duke qenë organ menaxhues dhe përgjegjës për çështje të edukimit dhe arsimit, fuqimisht mbështet përkujdesjen për ngritjen e cilësisë në procesin mësimor, përmirësimin dhe avancimin e vazhdueshëm të metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit të bazuar në rezultate dhe në zhvillimin e kompetencave duke implementuar Kurrikulën e re të Kosovës, me pjesëmarrje aktive të arsimtarëve në trajnime për këtë qëllim. DKA ka realizuar me përgjegjësi dhe kompetencë punët dhe detyrat e punës në fushën e arsimit në nivel komunal, respektivisht edhe monitorimin e mësimit në distancë në përputhje me Udhëzimet e MASH-it për DAK-të. Prioritet, përveç tjerash ka qenë edhe realizimi i mësimit online/në distancë për shkollat e nivelit parafillor (0), fillor (1-5), të mesëm të ulët (6-9) e mesëm të lartë (10 -12) për zbatimin e edukimit në distancë në Republikën e Kosovës e po ashtu edhe zbatimin e Plan-programit mësimor të organizuar nga MASH nëpërmjet procesit online.
DKA, po ashtu, ka ndërmarr edhe masa preventive për parandalimin e pandemisë COVID 19 duke i pajisur institucionet arsimore me të gjitha mjetet higjienike parandaluese dhe mbrojtëse si: maska, sapun, letër, dezinfektues me bazë alkooli, termometër digjital e posaçërisht dezinfektimi DDD (dezinfektimi-dezinsektimi-deratizimi) i objekteve shkollore.

## 3. Objektivat

- Përfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor; respektivisht gjithëpërfshirja që mundëson mbështetje për të gjithë nxënësit pavarësisht gjendjen e tyre fizike, intelektuale, sociale etj.
- Menaxhimi i sistemit arsimor i bazuar në transparencë e llogaridhënie

- Përmirësimi dhe avancimi i cilësisë në arsim në përputhje me standardet më të larta
- Zhvillimi profesional i mësimdhënësve për metodologjinë e mësimdhënjes dhe zbatimin e Kurrikulës së re të Kosovës si proces për zhvillimin dhe ngritjen profesionale
- Avancimi i të nxënit përmes mësimdhënies cilësore duke zbatuar kurrikulën e bazuar në pajisjen me teknologji informative dhe pajisje të TIK-ut e mjete tjera mësimore.
- Vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas standardeve, vlerësim i bazuar në rezultatet e të nxënit dhe reflektimi i performancës së nxënësit
- Sigurim i mjedisit të pastër e të favorshëm në shkollë; angazhim i gjithë stafit të shkollës
- Mbrojtja e shëndetit të fëmijëve si masë parandaluese në kushte pandemie
- Zbatimi i mësimit online në përputhje me kushtet e krijuara nga pandemia COVID 19

## 4. Nivelet e arsimit - Edukimi dhe arsimi parafillor dhe fillor (0 dhe 1)

Duke u bazuar në plan – programin për arsim parafillor dhe fillor, planin dinamik të punës, obligimet dhe përgjegjësitë e sektorit të arsimit në organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor dhe me qëllim të përmirësimit të sistemit arsimor, janë bërë të gjitha përpjekjet për gjithëpërfshirjen e fëmijëve në arsimin parafillor dhe fillor dhe eliminimin e dobësive dhe menaxhimin më cilësor të këtyre niveleve duke siguruar një sistem të plotë dhe efikas. Zhvillimi i hershëm i fëmijëve ndikon në krijimin e personalitetit , krijimin e identitetit personal të fëmiut, ngritjen e vetëbesimit, fillimin e zhvillimit të njohurive e shkathtësive në mënyrë që të vazhdojnë shkollimin – nivelin e mesëm të ulët e më tej.

Rëndësi e vaçantë, në këtë nivel arsimor, i është kushtuar zhvillimit dhe thellimit të dijes, kultivimit të identitetit personal, zhvillimit të përgjegjësive, aftësimit për jetë e punë e kompetenca tjera me qëllim që fëmijët të krijojnë kushte për zhvillim të pavarur personal dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies së shoqërisë në përgjithësi.

## 4.1 Rrjeti shkollor

Edhe gjatë vitit shkollor 2019/2020 kanë funksionuar 12 shkolla amë fillore dhe të mesme të ulëta dhe 12 paralele të ndara fizike:

1. SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik me paralelet e ndara në Dushkajë, Runjevë, Gjurgjedell dhe Kërbliq,
2. SHFMU "Idriz Seferi" në Bob me paralelet e ndara në Kovaçec e Gajre
3. SHFMU "Jusuf Gërvalla" në Biçec me paralelen e ndarë në Nikaj
4. SHFMU "Kadri Zeka" në Dubravë me paralelet e ndara në Vatë e Provoli
5. SHFMU "Ali Asllani" në Doganaj
6. SHFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj me paralelen e ndarë në Bajnicë
7. SHFMU "Qamil Ilazi" me paralelen e ndarë në Fushë të Pajtimit
8. SHFMU "7 Shtatori" në Begracë
9. SHFMU "Agim Bajrami në Stagovë
10. SHFMU " Gafurr Luma" në Gllobоçicë
11. SHFMU "Dituria" në Ivajë me paralelen e ndarë në Strazhë dhe
12. SHFMU "Naim Frashëri" në Kotlinë

Këtë vit shkollor, DKA sipas planit të punës dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë, ka marr vendim që 2 nxënësit e mbetur të nivelit 6-9 të paraleles së Gjurgjedellit të vijojnë në klasat përkatëse të shkollës në Bob, ndërkaq 4 fëmijë të tjerë të nivelit 1-5 kanë vazhduar të vijojnë në shkollën e Gjurgjedellit, paralele e ndarë e SHFMU "Emin Duraku" në Kaçanik.

DAK, synon përmirësimin e kushteve elementare dhe mirëmbajtjes së objekteve shkollore, me qëllim të ngritjes dhe avansimit të cilësisë dhe sigurimin e ambientit të shëndetshëm për zhvillimin e procesit mësimor. Bazuar në kushtet ekzistuese mundë të konstatojmë se rrjeti i shkollave të nivelit AF dhe AMU është relativisht i kënaqshëm. Në Komunën tonë gjatë këtij viti shkollor kanë funksionuar gjithsej 24 shkolla të nivelit fillor, të plota dhe jo të plota, ndërsa procesi mësimor për klasat 1-5 është zhvilluar në gjithsej 24 shkolla e në nivelin 6-9 është zhvilluar në 19 prej tyre.

Vlen të theksohet se gjatë vitit shkollor 2019/2020 janë finalizuar punimet për ndërtimin e 5 objekteve të reja, 4 objekte shkollore dhe objekti i ri i çerdhes për fëmijë. Në Gllobоçicë e Ivajë gjatë dhjetorit të vitit 2019 janë përuruar objektet e reja shkollore e po ashtu, gjatë dhjetorit të vitit 2019 është përuar edhe objekti i ri i çerdhes për fëmijë në Kaçanik, ndërkaq në shtator të vitit 2020, fëmijët e fshatit Kaçanik të Vjetër patën festë të dyfishtë: ata iu gëzuan fillimit të vitit të ri shkollor dhe hyrjes në objektin e ri e modern shkollor, sikurse edhe moshatarët e tyre nga fshati Kovaçec të cilët vitin e ri shkollor e nisën në objektin e ri shkollor.
Ndërtimi i objekteve shkollore në Kaçanik të Vjetër e Gllobоçicë janë financuar nga MASh (atëherë MAShT), objekti i çerdhës është financuar nga BE përmes MASh, ndërkaq 2 objektet në Ivajë dhe Kovaçec janë financuar nga buxheti i Komunës.

### 4.2 Nxënësit e nivelit 0 dhe 1 (Parafillor dhe Fillor) dhe suksesi

Numri i fëmijve parashkollor në këtë vit shkollor ishte 472 të shpërndarë në 25 paralele e 40 grupe, ndërkaq numri i nxënësve filloristë ka qenë gjithsej 2428, ndërsa prej tyre kanë vijuar gjithsej 2418. Procesi mësimorë me parashkollorë është zhvilluar po thuajse në të gjitha shkollat, me përjashtim të SHFMU "Naim Frasheri" në Kotlinë.

Në nivelin fillor nga gjithsej 2428 nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor, sukses pozitiv kanë treguar 2418, aq sa edhe kanë vijuar apo shprehur në përqindje 99.58 % . Të pa notuar kanë mbetur 10 ose shprehur në përqindje 0.42 %. Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të këtij niveli më atë të vitit të kaluar ( 2532 nxënës), atëherë del se në këtë vit shkollor 2019/2020 kanë qenë të regjistruar 104 nxënës më pak, ndërkaq nota mesatare e këtij niveli arsimor është 4.10.

Tabela Nr.1

Suksesi i nxënësve në Arsimin Fillor (I – V) në fund të vitin shkollor 2019-2020

| | | | | | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | TE PANOTUAR | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa | Gj.nxenes | | Vijojnë | | Shkelq. | | Sh.mire | | Mire | | Mjaft. | | Gj.pozitiv | | % | Me 1x1 | | Me 2x1 | | Me 3x1 | | Gj.negativ | | Nuk vijoj | | Te çregjist | | N mes |
| | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | |
| I | 469 | 214 | 467 | 213 | 308 | 161 | 92 | 30 | 50 | 22 | 15 | 7 | 467 | 213 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 | 4.29 |
| II | 504 | 236 | 500 | 236 | 298 | 165 | 102 | 48 | 71 | 20 | 29 | 8 | 500 | 235 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 3 | 0 | 4.07 |
| III | 485 | 243 | 485 | 243 | 215 | 129 | 131 | 62 | 105 | 45 | 35 | 7 | 485 | 243 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.95 |
| IV | 500 | 214 | 500 | 214 | 252 | 132 | 123 | 55 | 94 | 29 | 38 | 14 | 500 | 214 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4.03 |
| V | 470 | 227 | 466 | 224 | 242 | 130 | 97 | 45 | 93 | 42 | 31 | 7 | 466 | 224 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 3 | 2 | 4.04 |
| I-V | 2428 | 1134 | 2418 | 1130 | 1328 | 724 | 543 | 237 | 405 | 156 | 143 | 41 | 2418 | 1129 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 2 | 7 | 3 | 4.1 |

## 5. Nxënësit e nivelit 2 (VI –IX) dhe suksesi

Numri i nxënësve në nivelin e AMU gjatë viti shkollor 2019/2020 ishte 1959, prej tyre 997 femra, ndërsa rezultat pozitiv kanë arritur gjithsej 1942 ose 99.1 % e ndërkaq, 17 të tjerë kanë ngelur të panotuar ose 0.9 %. Nëse e krahasojmë numrin e nxënësve të këtij niveli me atë të një viti më parë (2034 nxënës), atëherë del se në këtë vit shkollor janë 75 nxënës më pak, ndërsa nota mesatare del të jetë 3.87.

Tabela 2.

Suksesi në Arsimin e Mesëm të Ulët (VI – IX) në fund të vitit shkollor 2018-2019

| | | | | | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | TE PANOTUAR | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa | Gj.nxenes | | Vijojnë | | Shkelq. | | Sh.mire | | Mire | | Mjaf | | Gj.pozitiv | | % | Me 1x1 | | Me 2x1 | | Me 3x1 | | Gj.negativ | | Nuk vijoj | | Te çregjist | | N mes |
| | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | |
| VI | 497 | 246 | 493 | 245 | 234 | 158 | 121 | 56 | 95 | 27 | 43 | 4 | 493 | 245 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 2 | 1 | 4.11 |
| VII | 487 | 231 | 483 | 230 | 171 | 125 | 118 | 66 | 139 | 30 | 55 | 10 | 483 | 230 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 2 | 1 | 3.72 |
| VIII | 480 | 266 | 477 | 264 | 189 | 146 | 105 | 62 | 129 | 44 | 57 | 11 | 477 | 264 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 2 | 1 | 3.88 |
| IX | 495 | 224 | 489 | 224 | 184 | 128 | 103 | 38 | 156 | 50 | 44 | 8 | 489 | 224 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 3 | 0 | 3.74 |
| VI-IX | 1959 | 967 | 1942 | 963 | 758 | 557 | 447 | 222 | 519 | 151 | 199 | 33 | 1942 | 963 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 8 | 1 | 9 | 3 | 3.87 |

## 6. Numri i nxënësve dhe suksesi në arsimin fillor dhe mesëm të ulët (I - V dhe VI – IX)

Numri i përgjithshëm i nxënësve në këto dy nivele, të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2019/20 ka qenë 4387 prej tyre 2101 femra, ndërsa kanë vijuar dhe janë vlerësuar 4360 (2093) ose 99.3 %. Nuk kanë vijuar, respektivisht të pa notuar kanë mbet 27 prej tyre ose 0.7 %. Nëse e krahasojmë këtë numër të nxënësve me numrin e regjistruar një vit më parë (4566), atëherë del se gjatë këtij viti shkollor numri i nxënësve të regjistruar është më i vogël për 179 nxënës. Nota mesatare e këtyre dy niveleve është 3.98.

Për më shumë shih Tabelën 3

Suksesi sipas klasave I – IX, në nivelin fillor dhe mesëm të ulët, viti shkollor 2019 - 2020

| | | | | | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | | | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | TE PANOTUAR | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa | Gj.nxenes | | Vijojnë | | Shkelq. | | Sh.mire | | Mire | | Mjaft. | | Gj.pozitiv | | % | Me 1x1 | | Me 2x1 | | Me 3x1 | | Gj.negativ | | Nuk vijojnë | | Te çreg | | Nota mesatare |
| | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | |
| I | 469 | 214 | 467 | 213 | 308 | 161 | 92 | 30 | 50 | 22 | 15 | 7 | 467 | 213 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 1 | 4.29 |
| II | 504 | 236 | 500 | 236 | 298 | 165 | 102 | 48 | 71 | 20 | 29 | 8 | 500 | 235 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 3 | 0 | 4.07 |
| III | 485 | 243 | 485 | 243 | 215 | 129 | 131 | 62 | 105 | 45 | 35 | 7 | 485 | 243 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.95 |
| IV | 500 | 214 | 500 | 214 | 252 | 132 | 123 | 55 | 94 | 29 | 38 | 14 | 500 | 214 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4.03 |
| V | 470 | 227 | 466 | 224 | 242 | 130 | 97 | 45 | 93 | 42 | 31 | 7 | 466 | 224 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 3 | 2 | 4.04 |
| I-V | 2428 | 1134 | 2418 | 1130 | 1328 | 724 | 543 | 237 | 405 | 156 | 143 | 41 | 2418 | 1129 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 2 | 7 | 3 | 4.1 |
| VI | 497 | 246 | 493 | 245 | 234 | 158 | 121 | 56 | 95 | 27 | 43 | 4 | 493 | 245 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 2 | 1 | 4.11 |
| VII | 487 | 231 | 483 | 230 | 171 | 125 | 118 | 66 | 139 | 30 | 55 | 10 | 483 | 230 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 2 | 1 | 3.72 |
| VIII | 480 | 266 | 477 | 264 | 189 | 146 | 105 | 62 | 129 | 44 | 57 | 11 | 477 | 264 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 2 | 1 | 3.88 |
| IX | 495 | 224 | 489 | 224 | 184 | 128 | 103 | 38 | 156 | 50 | 44 | 8 | 489 | 224 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 3 | 0 | 3.74 |
| VI-IX | 1959 | 967 | 1942 | 963 | 758 | 557 | 447 | 222 | 519 | 151 | 199 | 33 | 1942 | 963 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 8 | 1 | 9 | 3 | 3.87 |
| I-IX | 4387 | 2101 | 4360 | 2093 | 2106 | 1281 | 990 | 459 | 924 | 307 | 342 | 74 | 4360 | 2092 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 11 | 3 | 16 | 6 | 3.98 |

Suksesi i nxënësve sipas shkollave prezantohet përmes Tabelarit 4

| Nr. | shk oll. | Gjithsej nxënës | | Vijojnë | | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | Të Panotuar | | | | Nota mesatare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | shkëlq | | shumë mirë | | mirë | | mjaft. | | Gjithsej pozitiv | | | 1x1 | | 2x1 | | 3x1 | | Gj negativ | | Nuk vijojnë | | Çregjistruar | | |
| | | Gj | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | Gj | F | % | Gj | F | Gj | F | Gj | F | Gj | F | Gj. | F | | | |
| 1 | "E.D" | 1409 | 683 | 1398 | 680 | 678 | 415 | 327 | 162 | 299 | 89 | 94 | 21 | 1398 | 679 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 6 | 1 | 5 | 3 | 4.05 |
| 2 | "K.Z" | 410 | 186 | 405 | 185 | 169 | 105 | 105 | 49 | 88 | 24 | 43 | 7 | 405 | 185 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 | 1 | 3.94 |
| 3 | "I.S" | 479 | 238 | 479 | 238 | 249 | 154 | 118 | 56 | 88 | 23 | 24 | 5 | 479 | 238 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4.17 |
| 4 | "J.G" | 295 | 140 | 293 | 139 | 154 | 97 | 59 | 23 | 49 | 12 | 31 | 7 | 293 | 139 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 1 | 0 | 0 | 3.98 |
| 5 | "N.O. | 322 | 148 | 322 | 148 | 143 | 89 | 63 | 23 | 92 | 31 | 22 | 6 | 322 | 148 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.9 |
| 6 | "Q.I." | 422 | 218 | 422 | 218 | 245 | 155 | 90 | 38 | 66 | 23 | 16 | 3 | 422 | 218 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4.27 |
| 7 | "A.A" | 332 | 150 | 330 | 150 | 163 | 86 | 58 | 25 | 70 | 30 | 39 | 9 | 330 | 150 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 3.96 |
| 8 | "7.Sh | 287 | 144 | 287 | 144 | 139 | 81 | 50 | 29 | 72 | 46 | 35 | 8 | 287 | 144 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.89 |
| 9 | "G.L. | 145 | 65 | 145 | 65 | 60 | 34 | 33 | 15 | 38 | 11 | 14 | 5 | 145 | 65 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.9238 |
| 10 | "A.B. | 151 | 70 | 151 | 70 | 54 | 34 | 53 | 20 | 35 | 13 | 9 | 3 | 151 | 70 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3.95 |
| 11 | "Ditu | 98 | 42 | 92 | 40 | 40 | 22 | 24 | 12 | 16 | 5 | 11 | 0 | 92 | 40 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 6 | 2 | 4.02 |
| 12 | "N.F" | 37 | 17 | 36 | 16 | 12 | 9 | 10 | 7 | 11 | 0 | 4 | 0 | 36 | 16 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 3.76 |
| | Gjith | 4387 | 2101 | 4360 | 2093 | 2106 | 1281 | 990 | 459 | 924 | 307 | 342 | 74 | 4360 | 2092 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 11 | 3 | 16 | 6 | 3.98 |

## 7. Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve

Për t'u arritur suksesi i dëshiruar, komponentë e rëndësishme është vijueshmërija e rregullt e nxënësve, por edhe e mësimdhënësve në mësim. Mosvijimi i rregullt në orët e mësimit ndikon negativisht në suksesin e nxënësve, ndërkohë që ky faktor merret edhe si pasqyrë e mosdisiplinës së duhur në shkollë. Ndryshe, ky vit shkollor ka përfunduar në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë COVID 19. Vlen të theksohet se që nga 12 marsi, me vendim të qeverise Nr.01/7 të datës 11.03.2020 është ndërprerë procesi edukativo-arsimor të institucioneve arsimore publike e private në të gjitha nivelet, fillimisht deri më 27 mars, ndërkohë që ka vazhduar mësimi në distancë/online, që për shumë nxënës ka qenë sfidues pasi u kanë munguar pajisjet teknologjike.

Në dy nivelet arsimore (I – IX) gjatë këtij viti shkollor janë angazhuar gjithsej 358 mësimdhënës (171 femra) prej tyre 143 në mësimin klasor dhe 215 në atë lëndor, ndërsa të kualifikuar rezultojnë të jenë 353 apo shprehur në përqindje 98,61 %. Nxënësit e këtyre dy niveleve, AF dhe AMU në fund të vitit shkollor 2019/2020, kanë bërë gjithsejt 35928 mungesa prej tyre 30122 të arsyeshme, ose 8.18 orë për kokë nxënësi. Ndërkaq, mësimdhënësit gjatë këtij viti shkollor kanë humbur 1391 orë mësimore ose mesatarisht nga 3.83 orë për arsimtarë.

Për më shumë informata shih Tabelën 5

Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në vitin shkollor 2019 – 2020

| Nr. | Emri I shkolles | KUADRI ARSIMOR | | | | | | | | | | | | mungesat e nxënësve | | mesat. për nx. | orët e pa mbajtura të arsimtarëv | mesatarja për arsimtarë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Mësimi klasor | | | | Mësimi lëndor | | | | Dy ciklet | | | | | | | | |
| | | Gj | F | Kv | % | Gj | F | Kv | % | GJ | F | Kv | % | GJ | ARS. | | | |
| 1 | "Emin Duraku" | 36 | 33 | 35 | 97.22 | 47 | 22 | 46 | 97.87 | 83 | 55 | 81 | 97.51 | 16873 | 14324 | 11.75 | 137 | 4 |
| 2 | "Idriz Seferi" | 18 | 10 | 18 | 100 | 24 | 10 | 23 | 95.83 | 42 | 20 | 41 | 97.61 | 2068 | 1828 | 6.3 | 92 | 2.19 |
| 3 | "Kadri Zeka" | 15 | 4 | 15 | 100 | 17 | 3 | 16 | 94.11 | 32 | 7 | 31 | 96.87 | 2496 | 2117 | 6.08 | 145 | 4.53 |
| 4 | "Jusuf Gërvalla" | 12 | 9 | 12 | 100 | 17 | 6 | 17 | 100 | 29 | 15 | 29 | 100 | 3099 | 2519 | 10.57 | 121 | 3.9 |
| 5 | "Qamil Ilazi" | 13 | 8 | 13 | 100 | 18 | 8 | 20 | 100 | 31 | 16 | 31 | 100 | 5452 | 5062 | 12.19 | 263 | 7.96 |
| 6 | "Nazmi Osmani" | 11 | 8 | 11 | 100 | 16 | 7 | 16 | 100 | 27 | 15 | 27 | 100 | 638 | 422 | 1.9 | 214 | 7.92 |
| 7 | "Ali Asllani" | 8 | 5 | 8 | 100 | 17 | 3 | 17 | 100 | 25 | 8 | 25 | 100 | 646 | 436 | 1.95 | 206 | 8.24 |
| 8 | "7 Shtatori" | 7 | 3 | 7 | 100 | 17 | 11 | 16 | 94.11 | 24 | 14 | 23 | 95.80 | 1566 | 1083 | 5.45 | 29 | 1.21 |
| 9 | "G.Luma" | 5 | 3 | 5 | 100 | 8 | 2 | 8 | 100 | 13 | 5 | 13 | 100 | 346 | 268 | 2.38 | 26 | 2 |
| 10 | "A.B." | 5 | 3 | 5 | 100 | 10 | 2 | 10 | 100 | 15 | 5 | 15 | 100 | 1797 | 1576 | 11.9 | 60 | 4 |
| 11 | "Dituria" | 9 | 5 | 8 | 88.8 | 13 | 3 | 14 | 100 | 22 | 8 | 22 | 95.6 | 650 | 406 | 6.63 | 68 | 2.95 |
| 12 | "Naim Frashëri" | 4 | 0 | 4 | 100 | 11 | 3 | 11 | 100 | 15 | 3 | 15 | 100 | 297 | 81 | 10.66 | 30 | 2 |
| | Gjithsej | 143 | 91 | 141 | 98.6 | 215 | 80 | 214 | 98.18 | 358 | 171 | 353 | 98.61 | 35928 | 30122 | 8.18 | 1391 | 3.83 |

## 8. Edukimi dhe Arsimi i Mesëm i Lartë (AML)

Edukimi dhe arsimimi në nivelin 3, AML-së në komunën tonë zhvillohet në 2 shkolla: në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka". Ky nivel arsimor ka për qëllim formimin e çdo individi, zhvillimin intelektual e social, kritik e krijues por edhe bashkëpunues në mënyrë që të përballoj dhe të jetë i gatshëm për sfidat e së ardhmes, ndërkaq që në këtë nivel merren hapat për të vazhduar me sukses, më tutje në studimet superiore.

Në nivelin e AML-së, edhe këtë vit janë bërë përgatitjet e përgjithshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, përderisa që nga marsi për shkak të pandemisë COVID 19 janë krijuar rrethana të reja dhe të jashtëzakonshme.

Në të dy shkollat është vërejtur një mobilizim i shtuar sa i përket rifillimit të mësimit në kushtet dhe rrethanat e reja. Menjëherë pas ndërprerjës së procesit mësimor (më 12.03.2020) si pasojë e pandemisë COVID-19, bazuar në rekomandimet e tani MASh, DKA ka kontaktuar drejtorët e shkollave dhe ka filluar për realizimin e programit mësimor në distancë.
Shkolla e Mesme Profesionale "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka", mësimin në distancë e ka filluar më datë 23 mars dhe për të realizuar normalisht procesin edukativo-arsimorë kanë përdorë platformën elektronike Google Classroom ndërkaq, Gjimnnazi "Skënderbeu" mësimin në distancë e ka filluar më 30 mars, po ashtu duke përdorur platformën Google Clasroom.

### 8.1 Numri i nxënësve dhe suksesi në fund të vitit shkollor

Në vitin shkollor 2019-2020 në dy shkollat e mesme janë regjistruan gjithsej 1256 (693 mashkuj dhe 563 femra) prej tyre 718 në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 538 në ShMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka".
Në kuadër të Gjimnazit "Skënderbeu" kanë funksionuar 2 drejtime: Shkenca Natyrore dhe Shkenca Shoqërore-Gjuhësore, ndërsa në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" kanë funksionuar 3 drejtime:

1. Elekroteknikë me profilet: Teknik i Telekomunikacionit, Teknik i Informatikës dhe Instalues Elektrikë me nga 1 paralele,
2. Ekonomi me profilet: Kontabilitet, Asistent i Marketingut, Tregti me shumicë dhe Pakicë me nga 1 paralele dhe
3. Makineri me profilet: Instalues i ngrohjes qendrore, Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, Automekanik dhe Operator prodhimi, po ashtu, me nga 1 paralele.

Nga gjithsej 1256 nxënës të regjistruar në fillim të vitit shkollor 2019 - 2020 ( 214 më pak krahasuar me vitin e kaluar shkollor kur ishin të regjistruar 1470 nxënës), mësimin e kanë vijuar dhe janë vlerësuar gjithsej 1204 prej tyre, dhe që të gjithë kanë treguar rezultat pozitiv ose 95.85. Ndërsa të panotuar kanë mbetur 52 prej tyre ose 4.15 %, ndërkohë që nota mesatare e nxënësve për dy shkollat e mesme del 3.27, dhe atë në Gjimnazin "Skënderbeu" 3.91 e në SHMP "Feriz Guri dhe Vellezrit Çaka" 2.65.

Tabela Nr. 6

Suksesi i shkollave të mesme të larta në fund të vitit shkollor 2019 - 2020

| Emri i shkollës | klasa | Të regjistruar | | Vijojnë | | SUKSESI POZITIV | | | | | | | | | | % | SUKSESI NEGATIV | | | | | | | | TË PA NOTUAR | | | | nota mesatare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | shkëlq. | | sh.mirë | | mirë | | mjaft. | | Gjith pozitiv | | | 1X1 | | 1X2 | | Përsërisin me 3x1 | | Gjithsej negativ | | Nuk vijojn | | Të çregjistr | | |
| | | Gj | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | % | Gj | F | Gj | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | GJ | F | |
| "Skënderbeu" | X | 223 | 136 | 221 | 136 | 76 | 58 | 74 | 51 | 66 | 26 | 5 | 1 | 221 | 136 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 4.04 |
| | XI | 269 | 154 | 266 | 153 | 71 | 52 | 90 | 61 | 89 | 37 | 16 | 3 | 266 | 153 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 3 | 1 | 3.82 |
| | XII | 226 | 146 | 224 | 144 | 86 | 68 | 47 | 40 | 68 | 31 | 23 | 5 | 224 | 144 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 2 | 3.86 |
| | X-XII | 718 | 436 | 711 | 433 | 233 | 178 | 211 | 152 | 223 | 94 | 44 | 9 | 711 | 433 | 100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7 | 3 | 3.91 |
| Sh.M.Profesionale | X | 164 | 33 | 140 | 28 | 2 | 1 | 13 | 3 | 60 | 18 | 65 | 6 | 140 | 28 | 97.18 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 24 | 5 | 2.64 |
| | XI | 190 | 47 | 179 | 45 | 5 | 0 | 10 | 5 | 76 | 15 | 88 | 25 | 179 | 45 | 97.75 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 0 | 0 | 11 | 2 | 2.57 |
| | XII | 184 | 47 | 174 | 46 | 7 | 6 | 23 | 13 | 69 | 20 | 75 | 5 | 174 | 46 | 97.12 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 10 | 1 | 2.74 |
| | X-XII | 538 | 127 | 493 | 119 | 14 | 7 | 46 | 21 | 205 | 53 | 228 | 36 | 493 | 119 | 97.36 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 45 | 8 | 2.65 |
| Gjithsej | | 1256 | 563 | 1204 | 552 | 247 | 185 | 257 | 173 | 428 | 147 | 272 | 45 | 1204 | 552 | 66 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 52 | 11 | 3.27 |

### 8.2 Kuadri arsimor, mungesat e nxënësve dhe orët e pambajtura të mësimdhënësve

Një segment mjaft i rëndësishëm është edhe vijimi i rregullt i nxënësve e mësimdhënësve, ndërsa që është bërë përpjekje maksimale për uljen në minimum të mungesave të tyre.

Në fund të këtij viti shkollor nxënësit e këtij nivelit të AML-së kanë bërë gjithsejt 51,721 mungesa, prej të cilave 36,442 me arsye ose 41,17 për kokë nxënësi. Edhe numri i orëve të humbura është relativisht i lartë, ndërkaq kërkohet që shkollat të ndërmarrin edhe masa shtesë me qëllim të zvogëlimit në minimum të numrit të orëve të humbura mësimore. Ndryshe, ky vit shkollor ka përfunduar në kushte dhe rrethana të jashtëzakonshme për shkak të pandemisë COVID 19, ndërkaq që mësimi, pas ndërprerjes dy javore, ka vazhduar në distancë/online që ka qenë sfidë për shumë nga nxënësit e dy shkollave të mesme të larta.

Mësimdhënësit e këtij niveli kanë humbur gjithsej 745 orë mësimi apo 7.45 orë mësimi për një mësimdhënës.

Kualifikimi dhe ngritja profesionale, qasja e bazuar në kompetenca dhe rezultate është kusht elementar dhe kyq për realizimin e suksesshëm të plan-programit mësimor dhe njëkohësisht është faktor relevant për mësimdhënie e nxënie kualitative, dhe sigurim të cilësisë, andaj edhe këtë vit shkollor i është kushtuar vëmendje e veçantë ngritje dhe sigurim të cilësisë. Në fillim të vitit shkollor në dy shkollat e këtij niveli janë angazhuar gjithsej 100 mësimdhënës, prej tyre 98 të kualifikuar ose 98. % dhe ate në Gjimnazin "Skënderbeu" nga gjithsej 44 mësimdhënës prej tyre 43 janë të kualifikuar apo 97.72 % dhe në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka", nga gjithsej 56 mësimdhënës 55 janë të kualifikuar ose 98,21 %.

Për më shumë informata shih Tabelën Nr.7

| Nr. | Emri I shkollës | KUADRI ARSIMOR | | | | MUNGESAT E NXËNËSVE | | Mesatarja për nxënës | Orët e humbura të arsimtarëve | Mesatarja për arsimtarë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gj | F | KV | % | Gj | ARSYESHME | | | |
| 1 | "Skënderbeu" | 44 | 22 | 43 | 97.73 | 26273 | 20410 | 36.9 | 278 | 6.3 |
| 2 | SHMP | 56 | 17 | 55 | 98.21 | 25448 | 16032 | 47.3 | 467 | 8.33 |
| | Gjithsej | 100 | 39 | 98 | 98 | 51721 | 36442 | 42.1 | 745 | 7.45 |

## 9. Provimi i maturës

Testit të Maturës edhe sivjet, sikurse edhe viteve të mëhershëm, i janë nënshtruar nxënësit maturantë të 2 shkollave të mesme, por në kushte dhe rrethana të reja.
Komisioni Shtetëror i Maturës, fillimisht pati caktuar datën 4 korrik për mbajtjen e Provimit të Maturës Shtetërore 2020, duke marrë parasysh situatën me pandeminë, në përputhje me rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK). Sipas KShM, provimi i maturës do të organizohej në atë mënyrë që të ketë numër sa më të vogël të nxënësve/kandidatëve (nga 12 nxënës në një klasë) brenda një qendre të testimit dhe brenda klasave të testimit. Për shkak të rritjes së numrit të të infektuarve me COVID 19, provimi është shtyrë për datën 29 gusht 2020, duke respektuar masat për mbrojtjen dhe parandalimin e pandemisë.
Në test janë përfshirë tri lëndët obligative (Gjuhë amtare, Gjuhë angleze dhe Matematikë) dhe një lëndë zgjedhore (që është përzgjidhur nga vet kandidati nga lëndët zgjedhore në dispozicion) dhe vetëm në një pjesë e jo sikur herave tjera i ndarë në dy pjesë. .
Në Gjimnazin "Skënderbeu" nga gjithsej 230 maturant, sa i janë nënshtruar testit të maturës, atë e kanë kaluar gjithsej 173 prej tyre, apo 75.21 %, ndërsa 57 maturant, nuk kanë arritur rezultatin e nevojshëm. Ndërkaq, në SHMP "Feriz Guri e vëllezërit Çaka" , testin e kanë kaluar vetëm 29 maturant apo 22.83 %, nga gjithsej 127 sa iu kanë nënshtruar në këtë afat, ndërsa 98 prej tyre nuk kanë arritur t'a kalojnë pragun prej 40 % nga 100 pikë të mundshme. Nga të dhënat e publikuara, del se në nivel komunal, kalueshmëria është 56.58 % .
Sikurse edhe herave tjera, edhe sivjet është mbajtur afati i dytë i provimit të maturës. Në afatin e dytë të mbajtur më 10 tetor, në Gjimnazin "Skënderbeu" nga gjithsej 45 nxënës sa i janë nënshtruar testit të maturës, 33 prej tyre e kanë kaluar atë ose 73.33 %, ndërsa në SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" testin e kanë kaluar 35 ose 52,23 % nga gjithsej 67 sa kanë hyrë në provim. ose 52,23 % testit iu janë nënshtruar gjithsej 112 nxënës, ndërsa 68 prej tyre kanë treguar rezultat pozitiv apo 60.71%. Në afatin e dytë, në nivel komunal kalueshmëria është 60.71%.
Sivjet, në dy shkollat e mesme, mësimet i kanë vijuar 410 nxënës maturant, prej tyre 226 në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 184 në SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka".

Kaçanik, tetor 2020

Drejtori
Zahir Doda

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA